



PROJEKTI

VËZHIMI I PARIMEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË RUAJTJEN E VLERAVE TË QEVERISJES SË MIRË



Projekti është mbështetur
nga Bashkimi Evropian



ЦЕНТАР ЗА
УПРАВУВАЊЕ СО
ПРОМЕНИ





Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e "Qendrës për menaxhim me ndryshime" dhe në asnjë mënyrë nuk mund të llogaritet se i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



„VĚZHGIMI I PARIMEVE TĚ ADMINISTRATĚS PUBLIKE NĚ RUAJTJEN E VLERAVE TĚ QEVERISJES SĚ MIRĚ“

PROJEKTI



Projekti është mbështetur
nga Bashkimi Evropian



ЦЕНТАР ЗА
УПРАВУВАЊЕ СО
ПРОМЕНИ



Management Consulting Association

SCOOP
CIJ-MACEDONIA

VËZHGIMI I PARIMEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË RUAJTJEN E VLERAVE TË QEVERISJES SË MIRË

Cili është roli i reformës së administratës publike në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian?

- Reforma e administratës publike ka rëndësi thelbësore në proceset euro integruese, pasi që administrata publike funksionale

e paraqet shtyllën për përparim dhe zhvillim ekonomik të një vendi.

- Reforma e administratës publike është pjesë thelbësore nga reformat kyçe gjatë dialogut para aderimit me Bashkimin Evropian. Prandaj, kriteret për zgjerim të BE-së e theksojnë nevojën e çdo shteti të ndërtojë administratë publike nacionale me kapacitet, që t'i ndjeko parimet e qeverisjes së mirë dhe në mënyrë efektive ta transferojë dhe zbatojë legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Cilat janë SIGMA standardet dhe cilat fusha janë përcaktuar si kyçe për reforma dhe monitorim?

- Komisioni Evropian i kushton vëmendje të veçantë reformave në administratën publike përmes gjashtë fushave kyçe, në të cilat është i domosdoshëm progres në procesin e zgjerimit të BE. Këto gjashtë fusha të reformave, të cilat i përcakton KE, i caktojnë parimet e administratës publike. Parimet e administratës publike në mënyrë të hollësishme e definojnë konceptin e sundimit të mirë, si përcaktues të cilët duhet t'i përmbushin vendet gjatë procesit të integritimit në BE.
- Këto parime të administratës publike janë zhvilluar nga ana e SIGMA, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, dhe përdoren nga Komisioni Evropian për vëzhgimin e reformave në administratën publike nga ana e vendeve – kandidatë në BE. Përndryshe SIGMA është iniciativë e përbashkët e BE dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Evropian (OECD),

e themeluar në vitin 1992, e cila fokusohet në reforma të administratës publike dhe mbështetje për vendet në vendosjen e administratës publike profesionale.

- Vetë parimet përmbajnë edhe kornizë përmes së cilët ndiqet përparimi i vendeve në procesin e vendosjes së administratës publike profesionale, duke i shfrytëzuar indikatorët sasior dhe cilësor për vëzhgim.
- Fushat kyçe të defnuara në Parimet e administratës publike janë si vijojnë:
 1. Korniza strategjike e reformave të administratës publike
 2. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave
 3. Shërbimi publik dhe menaxhimi me resurset njerëzore
 4. Llogaridhënia
 5. Sigurimi i shërbimeve
 6. Menaxhimi me financat publike.

Cili është qëllimi kryesor i projektit dhe pse ka nevojë për përshtatjen e standardeve të SIGMA në nivel lokal?

- Standardet e përpiluara për qeverisje të mirë nga ana e SIGMA janë dedikuar, para së gjithash për institucionet qendrore shtetërore, të cilat i udhëheqin reformat e administratës publike në nivel qendror.
- Projekti "Vëzhgimi i parimeve të administratës publike në ruajtjen e vlerave të qeverisjes së mirë", i

cili është financuar nga Bashkimi Evropian, në suaza të IPA programit "Struktura për mbështetje e shoqërisë civile dhe Mediat 2015", fokusohet në vendosjen e standardeve për qeverisje të mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale, përmes përshtatjes së SIGMA Parimeve të administratës publike. Standardet të cilat janë dedikuar për autoritetet lokale, e ndjekin strukturën e SIGMA parimeve në raport me vendosjen e fushave, parimeve dhe metodologjisë për monitorim me indikatorë cilësor dhe sasior për çdo fushë, por e përshtatur në kontekstin e punës së njësjive të vetëqeverisjes lokale, të cilat funksionojnë ndryshe në raport me pushtetin qendror.

Si do të aplikohen standardet për qeverisje të mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale?

- Standardet për qeverisje të mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale, të përpiluara në suaza të këtij projekti, vendosin qëllime në 5 fusha:
 - Zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe strategjive
 - Shërbimi publik dhe menaxhimi me resurset njerëzore
 - Transparenca dhe llogaridhënia

- Sigurimi i shërbimeve
- Menaxhimi me financat komunale.
- Njësitë e vetëqeverisjes lokale do të ndiqen sipas standardeve të përcaktuara për qeverisje të mirë dhe metodologjinë e vendosur për monitorim, nga ana e organizatave qytetare lokale, të cilat janë inkuadruar si grantistë në projekt. Organizatat qytetare do të përgatisin raporte për punën e vetëqeverisjeve lokale nga regjioni i tyre, me rekomandime për përmirësimin e punës së komunave në kontekst të standardeve për qeverisje të mirë. Përmes dialogut me përfaqësuesit e komunave, do të ndikohet në ndryshimin e mënyrës së funksionimit të administratës lokale.

Cili është ndikimi i organizatave qytetare lokale?

- Përmes kësaj qasjeje, do ta forcojmë rolin e organizatave qytetare lokale, me qëllim që ato të mund të kenë pjesëmarrje më të madhe në procesin e krijimit të politikave në nivel lokal. Fokusi është vënë në forcimin e organizatave qytetare në:
 1. Aftësia për njohjen dhe monitorimin e parimeve për qeverisje të mirë
 2. Kapaciteti që të prodhohet hulumtim regional që mund të shërbejë për lobim
 3. Përdorimi i Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik në procesin e hulumtimit dhe analizës në punën e tyre.
 4. Njohja e parimeve themelore të punës së administratës publike, që shpie drejt përmbushjes së standardeve për qeverisje të mirë të institucioneve me kusht për hyrje në Bashkimin Evropian.

- Përshkaktë prezantimit adekuat të rezultateve nga puna e tyre para vetëqeverisjeve lokale dhe qytetarëve, organizatave qytetare lokale do t'u përmirësohen edhe kapacitetet në komunikim me aktorët shoqëror dhe mediat, shkathtësitë për krijimin e propozimeve të bazuara në dëshmi dhe prezantim i rezultateve të tyre hulumtuese për opinionin më të gjerë para rrjeteve gazetareske, të cilat e mbështesin dhe e stimulojnë gazetarinë qytetare.
- Një nga qëllimet specifike që projekti duhet t'i arrijë është vendosja në praktikë e ballafaqimit të argumenteve mes organizatave qytetare dhe njësjive të vetëqeverisjes lokale, që gjithsesi do të kontribuojë për funksionim më efikas të administratës lokale.
- Në këtë drejtim, projekti ka edhe një qëllim tjetër specifik, e ky është ta ngrejë vetëdijen publike, duke krijuar rrjete të organizatave qytetare dhe komunave, ku përvoja, pikëpamjet dhe idetë do të ndahen. Kjo duhet të jetë bazë për pozicionimin e organizatave qytetare si "roje" të sundimit të mirë, të cilët i ndjekin dhe i propozojnë masat korrigjuese.

Si funksionojnë komunitat në fushat e caktuara në standardet për qeverisje të mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale?

1. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe strategjive

- Në pajtim me kornizën juridike, procesi i krijimit të politikave është procesi i rregulluar, të cilin e koordinon një aktor. Sipas Ligjit për vetëqeverisjes lokale, në nivel lokal kjo është administrata komunale, e cila i përgatit aktet e këshillit dhe kryetari të komunës.
- E organizuar në sektorë, administrata komunale e përcjell problematikën në fushat që janë nën kompetencë të komunës, bën analiza të gjendjes dhe jep iniciativa dhe propozime për zgjidhjen e problemeve në komunë.
- Cikli i krijimit të politikave në nivel qendror është rregulluar në Metodologjinë për analizë të politikave dhe koordinim dhe më së miri mund të prezantohet në grafikon që vijon:



- Aktet me të cilat krijohet politika lokale janë: planet strategjike dhe të veprimit, programi i këshillit dhe programet sektoriale të komunës..

2. Shërbimi publik dhe menaxhimi me resurset njerëzore

- Organizimi i shërbimeve publike dhe administrata komunale janë shtylla bartëse të çdo komune dhe i kryejnë punët që janë kompetencë të organeve të komunës.
- Një pjesë e kompetencave të Kryetarit të komunës kanë të bëjnë me menaxhimin me resurset njerëzore, gjegjësisht me shërbimin publik dhe administratën komunale.
- Në këtë kontekst kryetari i komunës i realizon këto aktivitete:
 - E sjell rregulloren për sistematizim të vendeve të punës të administratës komunale
 - Zgjedh drejtorë të shërbimeve publike, të cilat i ka themeluar komuna, në bazë të konkursit publik
 - Udhëheq me administratën komunale
 - Vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën komunale, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj
- Statusi, klasifikimi, punësimi, avancimi, përsosja dhe aftësimi profesional, matja e efektit dhe çështje tjera lidhur me marrëdhëniet e punës të nëpunësve administrativ janë rregulluar me Ligjin për nëpunësit administrativ.

3. Transparenca dhe llogaridhënia

- Llogaridhënia është një nga fjalët më të përdorura në fjalorin e të gjithë funksionarëve publik. Kjo nënkupton se qytetarët gjithmonë duhet të dinë si bartësit e pushtetit, në nivel qendror dhe lokal, i shpenzojnë mjetet e grumbulluara financiare publike (përmes tatimeve dhe taksave tjera) dhe nëse ato shpenzohen për sigurimin e të mirave dhe shërbimeve të nevojshme publike për jetë më të mirë të qytetarëve.
- Për arritjen e këtij qëllimi, është e domosdoshme aplikimi i tërësishëm i parimeve të qeverisjes së mirë: participimi, sundimi i të drejtës, transparenca, përgjegjësia, konsensusi i përbashkët, barazia dhe inkluziviteti, efikasiteti dhe efektiviteti, llogaridhënia.
- Bazat e konceptit të qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies janë vendosur edhe në legjislacionin nacional. Funkzioni i këtyre ka më shumë dispozita kushtetuese, ligji për vetëqeverisje lokale, ligji për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik,

ligji për pengimin e korrupsionit dhe kodi etik i funksionarëve të zgjedhur.

- Llogaridhënia është e lidhur ngushtë edhe me transparencën, ndërsa për këtë qëllim komunat sjellin rregullore dhe plane për të qenit publik në punën e tyre.

4. Sigurimi i shërbimeve

- Sfidë kryesore për të gjitha komunat është krijimi i sektorit publik efikas në nivel lokal, i aftë të ballafaqohet me varfërinë dhe pabarazinë sociale, dhe të sigurojë shërbime cilësore, stabile dhe të parashikueshme për qytetarët dhe subjektet afariste.
- Sipas hulumtimeve, qytetarët më pak janë të kënaqur nga shërbimet në fushat e zhvillimit ekonomik lokal, veçanërisht në pjesën për rritjen e punësimit, si dhe informatat për shpenzimin e buxhetit komunal, ballafaqimi me korrupsionin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë vendimmarrjeve të rëndësishme me rëndësi lokale. Janë vlerësuar dobët edhe shërbimet në urbanizëm dhe planifikim, shërbimet komunale, mbrojtja sociale, mbrojtja e ambientit jetësor dhe mbrojtja shëndetësore.
- Komunat sigurojnë edhe shërbime të caktuara

për qytetarët dhe bashkësinë afariste përmes rrugës elektronike, siç janë dhënia e lejeve elektronike për ndërtim, paraqitja dhe pagesa e tatimeve, paraqitja e problemeve në komunë etj. Megjithatë, niveli i sigurimit të shërbimeve elektronike nga ana e komunave janë në nivel mjaft të ulët.

5. Menaxhimi me financat publike

- Korniza financiare e komunave caktohet me buxhetet, në të cilat deklarohen vlerat dhe prioritetet e vetëqeverisjes lokale. Buxheti dhe teknikat e planifikimit financiar janë elemente kyçe në ruajtjen e integritetit fiskal dhe veçanërisht janë të rëndësishme për të gjitha nivelet e pushtetit, duke përfshirë edhe pushtetin lokal. Kjo është mjaft e rëndësishme për shkak të ruajtjes së besimit të qytetarëve te ata të cilëve ua kanë besuar shpenzimin e parave të tyre.
- Vetëqeverisjet lokale duhet të kenë buxhetim real, gjegjësisht sistem për planifikim financiar. Planifikimi i të ardhurave duhet të jetë adekuat me nevojat e njësive të vetëqeverisjes lokale.
- Korniza fiskale e cila i definon të hyrat dhe të dalat në afat më të gjatë duhet të jetë transparente, stabile, me përgjegjësi, e ndershme dhe efikase.

Çfarë rezultatesh presim nga projekti?

- SIGMA parimet e përshtatura për administratën publike dhe indikatorë për monitorim për qeverisje të mirë në nivel lokal
- Organizatat qytetare lokale të bëhen kompetente në fushën e qeverisjes së mirë dhe mirë të njoftuara me SIGMA parimet për administratën publike në nivel nacional dhe lokal, të afta të marrin pjesë në dialogun për krijimin dhe ndjekjen e politikave publike
- Raportet e monitorimit për implementimin e SIGMA parimeve të përshtatura për administratën publike të përpiluara në bazë të hulumtimit të bazuar në dëshmi
- Organizata qytetare të afta të komunikojnë, të inkuadrohen dhe të ndikojnë mbi vendimmarrësit, që të njëjtit të mund t'i adresojnë lëshimet e identifikuar gjatë zbatimit të modelit për qeverisje të mirë nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale, duke nxitur transparencë, llogaridhënie dhe administratë e orientuar drejt serviseve..

Cilat aktivitete janë planifikuar në suaza të projektit?

- **Zbatimi i vlerësimit themelor të standardeve dhe praktikave ekzistuese të krijimit të politikave në nivel lokal në pajtim me SIGMA parimet.**

Do të bëhet analizë e punës së vetëqeverisjeve lokale në qendrat e shtatë regjioneve, të cilat janë pjesë e projektit, gjegjësisht në komunat Manastir, Strumicë, Shtip, Kumanovë, Veles, Tetovë dhe Strugë, me qëllim të vlerësimit të praktikave ekzistuese për krijimin e politikave publike dhe çfarë lloj i proceseve aplikohen në praktikë, në raport me fushat e definuara kyçe të punës nga standardet për qeverisje të mirë.

- **Përshtatja e SIGMA parimeve të administratës publike dhe përpilimi i standardeve për qeverisje të mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale**

SIGMA parimet administratës publike mbulojnë gjashtë fusha në kornizën për monitorim në nivel qendror. Kjo kornizë do të harmonizohet dhe përshtatet me specifikat dhe kontekstin e vetëqeverisjes lokale, gjatë së cilës do të vendosen standarde dhe indikatorë të ri në nivel lokal, bashkë me drejtimet e hollësishme për monitorim, të cilat do të shfrytëzohen që të sigurohet proces i standardizuar dhe efektiv i përcjelljes.

- **Identifikimi i organizatave qytetare partnere**

Përmes zgjedhjes së 14 organizatave qytetare lokale prej shtatë regjioneve (2 organizata për një regjion) për pjesëmarrje në aktivitete të projekteve, krijohet rrjeti nacional i organizatave qytetare lokale, të cilat do të përfshihen si partnerë në projekt, veçanërisht në procesin e monitorimit dhe evaluimit.

- **Trajnim i organizatave qytetare për qeverisje të mirë, komunikim dhe marrëdhënie me opinionin**

Forcimi i kapaciteteve të organizatave qytetare lokale do të zbatohet përmes trajnimeve në dy module:

Qeverisja e mirë

Qëllimi i këtij moduli është ta forcojë kuptimin e SIGMA parimeve nga ana e organizatave qytetare, si dhe roli i tyre në procesin e përcjelljes së administratës publike.

Fokusi është vënë mbi këto dy tema: SIGMA parimet në gjashtë fushat kyçe, dhe mënyra e monitorimit në gjashtë fushat kyçe, e cila zbatohet nga ana e SIGMA sipas metodologjisë për monitorim.

Komunikimi dhe prezantimi i rezultateve të organizatave qytetare

Moduli i dytë i trajnimit për organizatat qytetare është fokusuar në përmirësimin e shkathtësive komunikuese të organizatave qytetare dhe prezantimi i rezultateve të tyre para njësitë të vetëqeverisjes lokale dhe qytetarëve. Përfaqësuesit e organizatave qytetare do të trajnohen se si të shkruajnë kumtesë për opinionin, si të komunikojnë me mediat dhe gazetarët, si të plotësojnë kërkesë për qasje deri te informatat me karakter publik, si të arrijnë dukshmëri më të madhe në mediat dhe rrjetet e reja sociale etj.

- **Mentorimi i organizatave qytetare lokale për monitorim dhe evaluim**

Për organizatat qytetare të cilat do ta bëjnë monitorimin do të organizohen punëtori mentorimi, në të cilat do të sigurohet njohuri më e thellë për standardet e përpiluara për qeverisje të mirë në suaza të projektit, bashkë me metodologjinë e re për monitorim, sipas të cilës duhet të zbatohet procesi i vëzhgimit të vetëqeverisjeve lokale nga ana e organizatave qytetare. Gjatë punëtorive për mentorim, përfaqësuesit e organizatave qytetare do të trajnohen se si ta vëzhgojnë punën e vetëqeverisjeve lokale dhe si të llogarisin vlerat e të gjithë indikatorëve të definuar sasior dhe cilësor.

- **Skema për ri-grantim për monitorim të fushës specifike**

Në pajtim me planin e projektit, organizatat qytetare do të inkuadrohen si ri-grantistë, që t'i përcjellin njësitë e vetëqeverisjes lokale në formë të projekteve të vogla, të cilat do të realizohen në nivel lokal. Ata në të vërtetë do të implementojnë aktivitete të vogla projektesh, të cilat do të përfshijnë ekipe për grumbullimin e të dhënave, të shkruarit e raporteve dhe krijimi i studimeve të rastit, si dhe storje hulumtuese me qëllim të ndikimit më të gjerë mbi procesin e vendimmarrjes dhe politikave lokale. Projektet me ri-grantim do të mentorohen nga ana e ekipit të projektit, dhe në të njëjtën kohë do të angazhohen ekspertë nga organizatat partnere, me qëllim që të sigurohet ekspertizë teknike si sigurimi se të gjitha sfidat gjatë procesit të punës do të mund të tejkalohen.

- **Përgatitja e raporteve të monitorimit**

Procesi i monitorimit është një nga pjesët më të rëndësishme të këtij projekti, sepse vetëm procesi i monitorimit të rregullt dhe me kohë, sipas standardeve të definuara dhe mentorimit, mund të sjellë deri te raportet cilësore nga monitorimi. Gjithsej do të përgatiten 5 raporte monitorimi sipas regjioneve. Raportet do t'i ndjekin udhëzimet për monitorim, që në fund të fitohen raporte të standardizuara nga regjionet e ndryshme, me qëllim që ta prezantojë "fotografinë e madje" nga aspekti i mënyrës së funksionimit të vetëqeverisjeve lokale në vend, në drejtim të përmbushjes së standardeve të definuara për qeverisje të mirë.

- **Përgatitja e raportit final nga monitorimi**

Në fund parashihet që të përgatitet raporti final nga monitorimi, i cili do t'i integrojë të gjitha vlerësimet e monitorimit. Rezultatet e përgjithshme të raporteve finale nga monitorimi do të sigurojnë informata rreth asaj se si komunat duhet ta avancojnë punën e tyre, me qëllim të përmbushjes së standardeve të vendosura, me lëshime dhe gabime të adresuara dhe me rekomandime për

komunat, cilat aktivitete duhet t'i ndërmarrin që ta përmirësojnë punën e tyre.

Sfidat e përcaktuara në funksionimin e vetëqeverisjeve lokale dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e punës së tyre, duhet ta kenë ndikimin e tyre pozitiv në komunë, përmes stimulit të hapave pozitiv në secilën nga fushat e caktuara të standardeve.

- **Organizimi i debateve regjionale me njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe organizatat qytetare lokale**

Do të organizohen debate për rezultatet nga raportet në secilin regjion, me përfaqësues të organizatave qytetare partnere, organizata tjera qytetare, përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, ekipi i projektit dhe aktorë tjerë shoqëror relevant. Fokusi do të jetë mbi rezultatet nga monitorimi dhe identifikimi i lëshimeve në arritjen e standardeve për qeverisje të mirë. Këto debate duhet të shërbejnë si mundësi e shkëlqyeshme për takimin e përfaqësuesve të organizatave qytetare dhe njësitë të vetëqeverisjes lokale për shkëmbim të ideve dhe argumenteve, se në cilat fusha vetëqeverisjet lokale duhet investojnë përpjekje.

- **Organizimi i konferencës finale për rezultatet finale**

Do të organizohet konferencë finale me pjesëmarrje të gjitha organizatave qytetare dhe njësitë të vetëqeverisjes lokale, të cilat do të inkuadrohen në projekt. Krahas tyre, dot ë përfshihen edhe palët tjera të prekura, e veçanërisht institucionet qendrore, të cilat janë kompetente për zbatimin e rekomandimeve të caktuara në kuadër të projektit. Në këtë konferencë më e rëndësishmja është të prezantohen përfundimet nga të gjitha raportet finale të cilat do të përgatiten, me qëllim që të nxitë diskutim për atë se si të përmirësohet puna e njësitë të vetëqeverisjes lokale, me qëllim të arritjes së standardeve për qeverisje efikase dhe demokratike në nivel lokal.



ЦЕНТАР ЗА
УПРАВУВАЊЕ СО
ПРОМЕНИ

Qendra për menaxhim me ndryshime

rr. Rajko Zhinzifov nr. 1-44, Shkup
tel.: +389 (2) 6092-216
e-posta: info@cup.org.mk
ueb: www.cup.org.mk



Asociacioni për menaxhment konsulentë MKA 2000

rr. Nikolla Vapcarov nr. 2 kati 5, Shkup
tel.: +389 (0) 2 3217-446
e-posta: mca2000info@gmail.com
ueb: www.mca2000-.org



Qendra për gazetari hulumtuese SKUP

rr. "11 Oktomvri" nr. 4-5/2, Shkup
tel.: +389 (0) 2 3113-721
e-posta: info@scoop.mk
ueb: www.scoop.mk



